

KUSHTET E PERDORIMIT – IZI'S POST SH.P.K

(Kushtet e Përdorimit të Shërbimeve Postare)

Duke përdorur shërbimet e Izi's Post SH.P.K, ju pranoni dhe pajtoheni me të gjitha dispozitat e këtyre Kushteve të Shërbimit, të cilat rregullojnë ofrimin, transportin dhe trajtimin e dërgesave brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Këto kushte bazohen në Ligjin Nr. 06/L-038 Për Shërbimet Postare në Republikën e Kosovës dhe rregulloret përkatëse të ARKEP.

1. Objekti i Shërbimit

Objekti i këtyre Kushteve është ofrimi i shërbimeve postare dhe transporti i dërgesave nga Izi's Post në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe, sipas kërkesës, në shtete të tjera, për llogari të përdoruesve të shërbimit.

2. Kohëzgjatja e Përdorimit

Këto kushte vlejnë për sa kohë përdoruesi aktivizon dhe përdor shërbimet e Izi's Post.

Përdoruesi mund t'i ndërpresë ato në çdo moment duke ndaluar përdorimin e shërbimit, ndërsa Izi's Post mund t'i ndryshojë kushtet në çdo kohë me publikim në faqen zyrtare.

3. Përkufizime

Termat mëposhtme kanë këto kuptime:

Dërgesë postare – çdo dërgesë e adresuar në formë përfundimtare që trajtohet nga Izi's Post.

Dërgesë e thjeshtë postare – dërgesë pa dëshmi pranimi.

Dërgesë e regjistruar – dërgesë me regjistrim dhe kod unik gjurmimi.

Dërgesë e siguruar – dërgesë e mbuluar deri në vlerën e deklaruar nga dërguesi.

Pako postare – pako që përmban mall me ose pa vlerë komerciale.

•••••

- Pranim – marrja e dërgesës nga Izi's Post me qëllim shpërndarjen.
- Shpërndarja – dërgimi i dërgesës në adresën e caktuar.
- Dorëzimi – dorëzimi final i dërgesës te marrësi ose personi i autorizuar.

Shërbime të veçanta – regjistrim, sigurim, lajmërim-marrje, ekspres, COD, dërgesa të ndjeshme, të thyeshme, vetëm për marrësin.



4. Detyrimet e Përdoruesit të Shërbimit Përdoruesi i shërbimit (klienti) pajtohet të:

4.1 Plotësojë të dhëna të sakta

- Emër, mbiemër, adresë të plotë, numër telefoni.
- Përmasat, peshën, vlerën dhe përshkrimin e produktit.

Adresat e paplota shkaktojnë vonesë min. 24 orë.

4.2 Gjenerojë dhe vendosë etiketën

Çdo pako duhet të ketë etiketë të gjeneruar nga sistemi. Pako pa etiketë nuk pranohen.

4.3 Deklarojë vlerën reale të produktit

Kompensimi i humbjes/dëmtimit bëhet vetëm sipas vlerës së deklaruar nga përdoruesi.

4.4 Sigurojë paketim të duhur

Paketimi është përgjegjësi e plotë e përdoruesit. Dëmtimet nga paketimi i dobët nuk kompensohen.

4.5 Kontrollojë skanimin

Përdoruesi është përgjegjës të verifikojë në sistem që të gjitha dërgesat janë skanuar në momentin e pranimit nga kurieri.

4.6 Regjistrojë Ndërrimet & Rinisjet

Vetëm dërgesat e regjistruara në sistem si "Ndërrim" ose "Rinisje" trajtohen nga Izi's Post.

4.7 Raportoje problemet në kohë

- Brenda 2–3 ditëve për problemet e transportit.
- Brenda 14 ditëve për çdo ankesë tjetër.

4.8 Të mos dërgojë mall të ndaluar

Mallrat e ndaluara ligjërisht përbëjnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë të përdoruesit.

☒

5. Detyrimet e Izi's Post

5.1 Pranimi dhe dorëzimi

Shërbimet ofrohen nga 08:00–20:00, nga e hëna deri të shtunën.

5.2 Trajtimi i dërgesave

Dërgesat përpunohen dhe shpërndahen në kohën më të shkurtër të mundshme.

5.3 Përgjegjësia për dërgesat e skanuara

Izi's Post mban përgjegjësi vetëm për dërgesat e skanuara dhe të regjistruara në sistem.



5.4 Ruajtja e të dhënave

Izi's Post është e obliguar të respektojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin e dërguesve dhe marrësve.

5.5 Trajtimi elektronik

Statuset e dërgesave menaxhohen përmes aplikacioneve zyrtare me qasje të pakufizuar për klientin.

6. Barazimet dhe Pagesat

6.1 Barazimet

Përdoruesi duhet të konfirmojë barazimet financiare para çdo transferimi.

6.2 Transferimi i mjeteve COD

- Shërbimet brenda Kosovës → 24 orë
- Shërbimet jashtë Kosovës → 5 ditë

Izi's Post mban tarifën e shërbimit postar sipas listës së çmimeve të aprovuar.

7. Përgjegjësia dhe Kompensimi

Izi's Post kompenson vetëm për:

1. Humbjet e dërgesës së regjistruar, skanuar dhe pranuar nga Izi's Post
2. Dëmtimin e dërgesës gjatë transportit
3. Shpërndarjen e pa kryer ose të pasaktë
4. Vonimet e pajustificuara

Kompensimi bëhet sipas çmimit të furnizimit të produktit, jo sipas çmimit të shitjes.

7.1 Rastet kur Izi's Post nuk mban përgjegjësi

- Paketim i dobët nga klienti
- Vlerë e rreme e deklaruar
- Mall i ndaluar
- Dëme të shkaktuara nga organet shtetërore
- Ankesa të dorëzuara jashtë afatit
- Forca madhore
- Pranimit i dërgesës së refuzuar pa kontroll para kurierit
- Ndërrime ose Rinisje të paregjistruara në sistem



8. Forca Madhore

Izi's Post nuk mban përgjegjësi për vonesa ose mosfunksionime të shkaktuara nga:

••••

9. Mallrat Ndalohen

••••

vendime shtetërore,
trazira, luftë,
tërmete, përmbytje, fatkeqësi natyrore, rrethana jashtë kontrollit të saj.

e ndaluara rreptësisht:

armë, municion, eksploziv
narkotikë
substancë të rrezikshme dhe të paautorizuara
çdo mall i ndaluar me ligj të Republikës së Kosovës

Në rast shkeljeje, njoftohen menjëherë organet kompetente dhe përgjegjësia bie mbi dërguesin.

10. Konflikti i interesit dhe korrupsioni

Çdo përpjekje për të ofruar përfitime të padrejta për të ndikuar procesin e shërbimit e bën marrëdhënien kontraktuale të pavlefshme automatikisht.

11. Zgjidhja e Kontesteve

Të gjitha mosmarrëveshjet që nuk zgjidhen me marrëveshje do të trajtohen nga: Gjykata Komerciale e Republikës së Kosovës, në Prishtinë.

12. Ndërprerja e Marrëdhënies

Përdoruesi ose Izi's Post mund të ndërpresin përdorimin e shërbimit me njoftim 30-ditor.



13. Akti Përfundimtar

Duke klikuar “Pranoj Kushtet”, përdoruesi deklaron që:

- i ka lexuar dhe kuptuar këto Terms & Conditions,
- pranon përgjegjësitë e kësaj marrëdhënieje,
- pajtohet me të gjitha detyrimet dhe afatet e përfshira.

Izi's Post SH.P.K – Të gjitha të drejtat e rezervuara.



+ 383 (0) 49 715 000 | + 383 (0) 48 551 000



info@izis-post.com